



REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

CA Nr. 337/25 Dt. 03.06.2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

**Procesverbali për organizimin e konsultimit publik për Qarkoren e Pare
Buxhetore 2026/1 dhe KAB-in 2026-2028, konsultimi publik organizohet nga
kryetari i Komunës, Shaqir Totaj**

Publikimet:

Publikimet janë bërë me **22.05.2025** në webfaqe zyrtare të komunës, në facebook-un e komunës, si dhe në platformën e konsultimeve publike:

Në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/05/Njoftohen-te-gjithe-banoret-e-komunes-se-Prizrenit-per-organizimin-e-konsultimit-publik-per-Qarkoren-e-Pare-Buxhetore-dhe-KAB-in-Shq-Bosh-Tur.pdf>.

Në platformë: <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42823>

Njoftimi si lajm në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/news/njoftim-per-organizimin-e-konsultimit-publik-per-qarkoren-e-pare-buxhetore-dhe-kab-in-2026-28-kryetari-i-komunes-shaqir-totaj/>.

Njoftimi në Facebook:

<https://www.facebook.com/share/p/1AcLZptRos/>

Me 22.05.2025, njoftimi dhe projekt-rregullorja (në tri gjuhë) u është dërguar përmes emailit, qytetarëve, klubet sportive, OJQ, organizata të ndryshme, drejtor të shkollave, bizneseve, organizatat studentore, ekspert të fushave, mediat lokale, shoqatave të ndryshme si dhe organizata rinore, që të kenë mundësi të njihen më detajshëm me dokumentin në fjalë, sepse disa nga ta nuk kishin pasur mundësi ta lexonin të publikuar në ueb faqe.

Me 30.05.2025, është mbajtur konsultimi publik, vegëza e publikimit të lajmit për mbajtjen e konsultimit:

Në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/news/u-mbajt-konsultim-publik-per-qarkoren-e-pare-buxhetore-2026-01-dhe-kornizen-afatmesme-buxhetore-kab-2026-2028/>

Në facebook:

<https://www.facebook.com/share/p/1B7vkikx8i/>

Konsultimi është mbajtur në sallën e kuvendit komunal (Shtëpia e Bardh) dhe ka filluar në orën 10:13

Ymer Berisha, Udhëheqës i Njesisë së Komunikimit me Publikun, ka bërë hapjen e konsultimit publik, duke thënë se kam kënaqësinë që sot para jush edhe të gjithë qytetarëve të zbardhin KAB-in ose Kornizën e Afatmesme Buxhetore të shpenzimeve të komunës së Prizrenit.

Kërkesa e kryetarit të komunës z.Shaqir Totaj ka qenë që të gjitha zyrat profesionale të jenë në zbatimin të ligjit dhe kërkesat të këtij, në zbatim të praktikave të mira të cilat shkojnë për llogari të qytetarëve dhe në këtë rast politika më e madhe e një komune është korniza e shpenzimeve buxhetore për vitin 2026.

Kështu që thjesht jemi duke implementuar modelin e demokracisë vendimmarrëse, partneriteti duhet të jetë me qytetarët, për qytetarët dhe të gjitha këto investimet do të shkojnë në përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre, por do të jemi në

partneritet të vazhdueshëm. Domethënë, ideja e kryetarit Totaj ka qenë që i gjithë kapaciteti i komunës së Prizrenit të del dhe të konsultohet ose të dëgjohet edhe zëri i qytetarëve. Ligjet e tij po e provojnë që të bëjnë një pjesë sot, kështu që ky dokument është i afishuar edhe në web faqet të komunës. Janë edhe persona zyrtarë përgjegjës me email dhe adresa ku mund të dërgoni idetë që ju mund të keni.

Kemi dijeni se roli i medias është mjaft i madh, meqë një pjesë e madhe qytetare nuk mund të jetë fizikisht këtu dhe mesazhi ynë të shkojë në secilën familje, se cilat janë veprimet e komunës së tyre dhe ju jeni duke e parë që komuna Prizreni tashmë e ka shumë më të lehtë komunikimin me qenë shumë e paksi ekspert i kësaj fushe, për arsye se rezultatet flasin vetë.

Konsultimi i sotëm do të jetë këtë këtë protokoll normalisht tash kryetari i komunës nëse ka agjenda nga më të mëdha, kemi kërkuar që kurdo që ka mundësi të ketë prani fizike të njerëzve të jetë me fjalët e tij aty edhe me bashkëbisedimin me qytetarët. Dhe do të ketë fjalë elaboruese për kornizën e afatmesme buxhetore të komunës.

Pastaj disa detaje se sa është lartësia e buxhetit të komunës e kemi drejtorin e ekonomisë dhe financave që do të jetë një analitik të shkurtër dhe pastaj do e kalojmë fjalën te ju të nderuar të pranishëm. Ngrihet dorën emër-mbiemër, këtë përfaqësoni edhe kërkesa profesionale është që sivjet ose në këtë rast do të propozoni për vitin 2026 deri në vitin 2028 cilat projekte do të kishin dëshirë që të futeshin në këtë dokument që po e diskutojmë sot.

Shaqir Totaj, kryetar i komunës së Prizrenit ju përsëritet të gjithëve dhe ju falënderoj që keni ardhur sot këtu. Me ju thënë të drejtën, unë kam pritur që të ketë më shumë njerëz në konsultim, sidomos që kanë kuptuar më shumë gra që do të ketë. Për shkak që është shumë e rëndësishme që edhe gra të marrin pjesë në dhënien e ideve dhe informatave se çka duhet bërë nga buxheti.

Sidoqoftë janë afatet ligjore dhe është obligim ligjor, por përtej obligimit ligjor është edhe obligim moral edhe qytetarë, pra edhe kolegjeve, që të bashkohen të bisedojmë me qytetarët të territorit të komunës së Prizrenit, për shkak se investimet të cilat duhet t'i bëjmë.

Në fakt, janë në qëllim të përmirësimit të kualitetit të jetës të të gjithë juve edhe të atyre të tjerëve që nuk janë këtu. Edhe sa më shumë informatat të na jepni, në fakt na ndihmoni për të identifikuar prioritetet edhe qartë, edhe kualiteti i vendimeve të marra në momentin e krijimit të buxhetit për periudhën afatmesme trevjeçare.

Kualiteti i vendimeve të marrëve do të jetë më i madh, sa më shumë të kemi informacione kthyes nga ana e komunitetit, në përgjithësi të territorit të komunës së Prizrenit. Për detyrat, për numrat, për dëmet, po t'ju flet drejtori i financave.

Unë veç po dua me ju thënë që diku 15% të buxhetit komuna e krijon vetë prej të hyre vetanake. Edhe në këtë kontekst i inkurajoj të gjithë qytetarët e territorit të komunës që t'i kryejnë obligimet e veta për shkak se sa më e madhe të jetë pjesa e buxhetit që ne e krijojmë vetë, aq më e madhe do të jetë liria se ka do t'i shpërndajmë edhe ka do t'i bëjmë ato mjete. Është përshtypja e përgjithshme se deri më tani këto tri-katër vjetët e fundit e kemi pasur një shfrytëzim të mirëve të buxhetit.

Është e kuptueshme edhe e vetkuptueshme se tërësia e nevojave të qytetit është më e madhe sesa kapaciteti financiar i komunës që është. Prandaj duhet të jemi shumë të kujdesshëm, shumë bashkëpunues, në mënyrë që t'i caktojmë prioritetet duke tentuar që të prekim sa më shumë banorët e territorit të komunës të Prizrenit edhe në aspektin gjeografik kemi një shtrirje më racionale edhe sa më gjithëpërfshirëse.

Ballafaqohem shumë shpesh me kërkesat, pse s'u mbajmë mbas kësaj e na japim komplimente për punët e grupit, por pastaj kanë kërkesa pse nuk u bëra dhe kjo, pse nuk u bëra dhe kjo. Për këtë gjë është shumë e thjeshtë, nuk mundem me punu më shumë sa që kemi buxhet. Domethënë disa punë që kanë mbetur pa u përfunduar ose pa filluar janë si pasojë e mungesës së buxhetit, sepse buxheti ynë është veç e kemi pasur bartjen në këtë vit faktikisht. 70 milionë do të bëjë vullnet. Po, 70 milionë edhe investime kapitale 23 milionë, kurse për vitin e ardhshëm e kemi 25 e 200 milionë.

Në anën tjetër ju e dini që e kemi një hapësirë të madhe të pashfrytëzuar për bashkëpunim me qeverinë qendrore, ku ne gjithmonë jemi gati për bashkëpunim, meje po të njëjtat jo mundem e konstatuar edhe ato pjesëttjetër, por megjithatë, për mos me e thënë shumë dhe mos me u bë monitor, ju inkurajoj që të identifikoni problemet, t'i paraqitni kërkesat e kërkesat janë gjithmonë rezultat i nevojave. E dimë që asnjë kërkesë nuk është e paarsyeshme, po e rëndësishme është me i paraqit ato që janë më të rëndësishme si prioritet e pastaj për pjesën tjetër aq sa kemi mjete financiare, aq do t'i fusim në buxhetine komunës së Prizrenit, gjithmonë duke i marrë parasysh që edhe ato kriteret profesionale të cilat kemi të obliguar për me i zbatuar.

Sulltan Badallaj, drejtori i Drejtoritë së Ekonomisë dhe Financave, pas marrjes së qarkores së parë buxhetore nga ministria në 15 maj, ne menjëherë kemi filluar me përgatitjen e planifikimin e buxhetit, pra kornizën afatmesme buxhetore si hapi i parë që është.

Përmes qarkores buxhetore nga ministria, domethënë na është caktuar edhe kufijtë buxhetorë nëpër kategorive burime të tjera të financimit. Ajo buxheti si tërësi përbëhet nga këto burime të financimit. Po besoj që e keni edhe ju përpara materialin. Grant i përgjithshëm i cili vjen nga qeveria prej 31,387,250.00 euro. Grant i arsimit 22,967,574.00 grant i shëndetësisë prej 6,904,266.00. Ndërsa për qendrën kulturore në Zym janë 59,802.00 euro. Shërbimet rezidenciale në kuadër të Departamentit të për mirëqenien sociale e cila është 630,000.00 euro. Te financimi i teatrit janë ndarë me 330,553.00 euro. Të hyrat vetanake janë një planifikim prej 11,365.867 apo në përqindje që janë diku 15% nga vetë financimi i të hyrave që mblihdhen nga gjithë qytetarët e komunës së Prizrenit. Ndërsa financimi nga huamarrjes është 1,400,000.00.

Bashkim Gashi, besoj që në atë që thotë kryetari do të thotë në këto parametra të cilat duhet të parashihet do të thotë kjo pjesë e buxhetit për tri vjet e ardhshëm të komunës së Prizrenit është ajo që të investohet edhe në komunitetet pakicë. Unë e kam një propozim konkret do të thotë të cilit besoj se i ka ardhur koha dhe rendi që të realizohet.

Është në propozim do të thotë ndërtimi i një qendër kulturore Rome në Prizren. Besoj që në 30-të të ardhshme në rast se ndahet vite për vite, ka një pjesë e caktuar, do të realizohet brenda tri vjet edhe një iniciativë, këtë e thamë duke marrë parasysh do të thotë aktivitetet edhe rezultatet të cilët i kanë edhe pse komunitet numër të vogël do të thotë, por rezultatet e tyre në lëminë e kulturës janë të dukshme.

Në qendër do të thotë kishte me e rrumbullakosur pjesën e kulturës do të thotë edhe të komuniteteve, kur e dimë që qendra kulturore Bashnjako është ndërtuar, ndërtimi i qendrës turke është në proces, do të thotë me këtë Romë e kishin me rrumbullaksu si komunë, edhe përgjithësisht si qytetarë të kësaj komune do të thotë, besoj që në këtë e kishin me pasur edhe donacione, në rast se kishte komuna me ndarë një pjesë, ndoshta të caktuar të mjeteve, edhe donatorët tjerëkishin me qenë do të thotë të interesuar që të bashkë financojnë sëbashku me komunën edhe për tri vjet të ardhshme kishin me pasur një qendër ku kishin me i mundësuar të gjithë atyre aktivistëve do të thotë të zhvillojnë aktivitetet e tyre në shtëpinë e tyre.

Amir Bajrami, kryetar i bashkësisë lokale Streck Moshnik Konkordi Sel Prillovë. Unë kam pak këtu rreth buxhetit 75 milionë, kjo është keq i mirë, respekt edhe për qytetin. Por unë kisha pasur një dëshirë kështu, ky buxhet për vitet e ardhshme pak më shumë edhe të dhënë për katunde.

E kam një pyetje. Për shembull, fshati Gornë Sello nuk ka hala stadioni. Nëse ka mundësi me hy gjatë këto tre vite kështu.

Shani Tanaj, përfaqësoj bashkësinë lokale Mazrek, Kujush, Planaj, Milaj dhe Gorazh. Edhe unë kam disa kërkesa për buxhetin për tri vitet e ardhshme, sepse në fshatrat unë i përfaqësoj nuk është që ka pasuri investime. Kam bërë kërkesa por prapë do t'i përsëris ato kërkesa. Për fshatin Mazrek, investim në infrastrukturë rrugore, ndriçim publik. Gjithashtu dhe për fshatrat të tjera që i përfaqësoj, këto janë kërkesat përgjithësi.

Fakik Berisha, jam përfaqësues i fshatit Piranë. Fshati ynë ka problemin e deponisë mbasi jemi shumë afër deponisë të mbeturinave. E di që diçka është është bërë një projekt që është për mbjelljen e tyre apo që mos shpërndahen, po mos jemi ne shumë afër nga deponia ata kalojnë në fshatin.

Herolind Osmanollaj- i nderuar kryetar i komunës së Prizrenit zot Shaqi Totaj, të nderuar kryetar bashkie lokale, media dhe qytetarët të Prizrenit. Unë së pari dua ta falenderoj kryetarin e komunës së Prizrenit zotin Shaqi Totaj në emrin këtij personal dhe në emër të shirit lokal të fshatrave Gjonaj dhe Tupec, i cili me të vërtetë ka bërë një punë të mrekullueshme rregullimin e infrastrukturës, kryesisht në fshatin Gjonaj.

Dhe dua t'i ri përsëris prioritetet që janë për tri vitet e ardhshme. Unë po ashtu kam bërë edhe një kërkesë për drejtorinë e administratës, se tani dhe më të gjithë e dimë se zyrtari i gjendjes civile në Gjonaj ka shkuar në pension, andaj kërkoj edhe hapjen e konkursit për gjyqtarët që janë në civile, për tëshërbime më afër.

Po ashtu për drejtorinë e shërbimeve publike. Unë para një jave kam bërë një kërkesë edhe për zyrën e kryetarit edhe për drejtorinë e shërbimeve publike. Kryetar, me të vërtetë fshati Gjonaj ka nevojë për rregullimin e rrugës kryesore Gjonaj rruga është në një gjendje të mjerueshme. Kërkoj që sa më parë të me të ndërmerre diçka.

Po ashtu edhe rregullimin e kanalizimit në disa lagje të fshatit dhe rrugica tjerë. Po ashtu kam bërë kërkesa edhe në drejtorinë e emergjencave për aktivizimin e njësisë së zjarrfikëseve në fshatin Gjonaj, i cili me të vërtetë për atë rajon kishte qenë një vlerë e shtuar dhe pas në zjarrfikësit në rajonin e Hasit. Kërkesat për drejtorinë e shërbimeve publike për fshatin Tupec është rregullimin e trotuarit. Aty e dimë domethënë është edhe shkolla fillore e mesme Zenun Çoçaj ku ata nxënës nuk kanë trotuar, nuk kanë ndriçim, gjë që i pamundëson dhe i vështirëson lëvizjen. Si dhe rregullimin e rrugëve lokale, në këtë fshat, kanalizimin e tjerë.

Po ashtu edhe me drejtorin e shëndetësisë kanë pasur një kontakt dhe kanë bërë një kërkesë për një autoambulancë për qendrën e mjekësisë familjare cili ka thënë do ta shfrytëzoj mundësinë.

Siç e dini edhe ju do jeni klub i futbollit siç do jeni i parë as këtë vit do të merrni pjesë në garat e Ligës të dytë të Kosovës të Kosovës. Atëherë kërkojmë rregullimin e zveshtoreve dhe të tribunave sepse me të vërtetë needhepse jemi vendas që duhet t'i zhvillojmë ndeshjet, i zhvillojmë në stacionin e lirisë ose në Arbanas ose kudo tjetër.

Resmije Krasniqi, OJQ "Hader" zotri kryetar, dhe gjithë pranishmit të që jemi, si dhe publikun. Kërkesa jonë është që ta ketë një buxhet urgjent, mundësisht se sipas nevojëve, unë po flas për regjionet time, por edhe regjionet të tjera kanë nevojë të jetë buxheti urgjencë. Përshëmbull, si përshëmbull, po merr në shoqatën Hadër.

Ndoshta në lidhje jam brenda mjekës në gjithë, kryetar e shoqatës Hadër, me 205 anëtarë, qysh ka 90 nota deri tash. Ne kemi arritur shumë gjëra, por shumë me vështirësi. Sidomos sivjet, vështirësi të madhe kemi pasur nga ana punëtore buxhetit. E kisha lutur kryetarin dhe juve të keni një buxhet urgjencë, ku këto nevoja e shoqatave janë shumë të vështirë. Unë punoj për shoqatën time ku i kam me nevoja të veçanta. Për atë, ta kemi dhe mundësisht një nga ana e komunës, një kujdestar të jetë nga ana buxhetit që ju i ditën për nevojat e veçanta femra dhe kujdestar një kujdestar mashkull. Për atë, shumë keq o të na ha, se nuk kemi mundësi të ballafaqohemi me ta.

Edhe një pyetje tjetër nëse ka mundësi. Në komunën e Prizrenit, drejtori kulturës që dy vjet me nuk marrin projekte, megjithatë që krejt ja kemi përmbushur çka o ka ndeshur me aplikuar. Nuk e di pse. A thua pse këto personat që janë me të meta mentale dhe ka nevojë edhe këto ta kanë një kulturë, por nuk ka si. E kështu të kulturës i marrin që janë në Qendër për Punë Sociale në Drejtori, aty marrin buxhete, e personat tjerë nuk kanë nevojë të marrin kulturë, nuk e di pse.

Simon Veseli, përshëndetje për kryetarin, përshëndetje për gjithë shoqëruesit që jeni këtu për, bashkë me kryetarin. Ëh, Ky projekt më gjej po them ashtu për tri vite e ardhshme, që sa pata mundësi për me e shikuar tani për tani, për ne është shumë e qartë. Mirëpo, edhe është shumë i mirë, po na vjen shumë mirë që për çdo vit buxheti i Kuvendit Komunal të Prizrenit nuk po rritet, kjo është meritë edhe qytetarëve, sigurishtpër vetësimi i qytetarëve po e bëjnë të veten. Për të dytën në interes që është i sotëm.

Mirëpo unë doja me ju pyet, kemi bërë disa kërkesa edhe në tetor të vitit të kaluar, kur ka qenë rishikimi i buxhetit edhe në janar të këtij vitit edhe për çudi është harruar një praktikë që kërkesat që u bëheshin, që ishin prej fshatrave të ndryshme, u

thyeshim në bisedë, u thyeshim në konsultim, u sqaroshim, ka mundësi, s'ka mundësi. Kohën e fundit disi edhe pse bëjmë kërkesa nuk na nuk përfillen në një mënyrë, ndoshta janë shumë në zonën, punëtorët e administratës ose ndoshta janë shumë të angazhuar. Po disi është zbehët ajo praktikë.

Edhe për këtë arsye tani jam i detyruar edhe njëherë me e përmend se në datën 24 janar të vitit 2025 kam bërë një kërkesë si kryetar i bashkësisë lokale për pesë fshatrat, po kërkesën nuk e kam bërë për një fshat, por e kam bërë një kërkesë për të gjitha fshatrat, që ka qenë më së pari për fshatin Velesh, rregullimi i tri urave, që janë një orë është gjysëm e punuar, nuk di çka është bërë, nuk është vu pllaka, ka nevojë edhe një orë tjetër me u zgjeru, edhe rrugë e re fushore.

Por dua me ju njoftuar se për çfarë na dihen kërkesat që u bënë për Vorreza i kena grumbulluar mjetet me me vetë me vetë aksionin e qytetarëve dhe Vorreza që s'po e di ku pritet me me filluar se tani për tani kompanitë që kryejnë punë janë të nxëna, por e kanë kontraktuar, besoj që është e kryer, kishte me qenë mirë, ndoshta ndonjë pjesë pastaj, të atij segmenti, me marrë pjesë për respekt, se përndryshe farat janë të siguruar, po me kriju një urë bashkëpunimi mes komunës edhe komunitetit. Edhe për Shkodrën kam bërë kërkesë edhe për një kanalizim në lagjen Ramësi, edhe nja 400 m që është në mbetësi gjithësesi 250 m edhe rrugë diku 400 m me kubëza. Kam bërë një kërkesë edhe për familjen Shtufi, prapë është një gjendje alarmante, e kam pas njoftuar edhe drejtoreshën, e kam njoftuar drejtoreshën se sa herë që bjen në shi, i ngritet uji, niveli i ujit futet në oborr, për një mur i mbrojt, domethënë edhe për familjen Shtufi.

Shaqir Totja, kryetar i komunës së Prizrenit, unë do ju falenderoj për të gjitha këto pikat që i përmendet dhe këto kërkesa edhe po dua me e ritheksu që të gjitha këto kërkesa janë legjitime. Edhe asnjëra nuk është e panevojshme apo e tehur.

Mirëpo ato që ju thamë që mundësitë buxhetore nuk janë të mëdha, mirpo janë pranuar me adresuar krejt. Por megjithatë, unë i regjistrova disa pika që më duken kështu më specifike edhe kemi kaluar shpejt e shpejt. Përdiç kemi informata, përdit ç kemi pajtueshmëri, përdiç kemi informata që ju nuk e dini çfarë ka ndodhur ndërkohë. Për shembull, unë më pëlqej propozimi i Bashkimit për Qendrën Kulturore Roma, për shkak se Prizreni si qytet i diversitetit takon në njëfarë mënyre që çdo komunitet sado i vogël ai e përmirëson.

Edhe derisa e kemi një Qendër Kulturore boshnjake në ndërtimi kam premtuar edhe organizatave joqeveritare të komunitetit rom, se në periudhën e ardhshme, mandatin e ardhshëm, këtë periudhë tri vjeçare e tashme, do ta fusim në program edhe jam optimist që do ta analizojmë këto për shkak se me të vërtetë ai komunitet ka vlera kulturore artistike.

U përmend buxheti përfshirë nga jo veç për qytetin. Plotësisht me vend është kjo. Mirëpo edhe duke pasur parasysh faktin se qysh është struktura e banorëve. Dhe ne e dimë që përpara e kemi pasur parasysh së bashku barabartë, por e dimë që për shkak të ikjes së qytetarëve të Kosovës, tash kemi diku afërsisht 60% e banorëve është në qytet dhe pjesa tjetër është çka përbehet nëpër fshatra.

Prandaj konform shpërndarjes së numrit të banorëve, edhe territorit, bëhen edhe investimet, por gjithësesi asnjë fshat edhe asnjë komunitet nuk do të bëhet pa investime. Por infrastruktura për për fshatrat e Hasit, veç kemi punuar diçka, por në të ardhmen prap do të ketë investime të tjera, asnjëherë s'kemi me mundur me plotësuar gjithë kërkesat. Përsa i përket deponisë Landovicë është kompetencë e ministrisë. Edhe unë e di se kemi pasur një takim me një kompani gjermane e cila veç është i madh me qasjen e deponisë. Ata e kanë një projekt konkret për rregullimin, diku, qysh më kanë thënë, për një periudhë 30 vjeçare. E se i përket qendrës, veç kemi bërë lëvizje.

Nuk e kemi zgjedhur problemin, por e kemi zbutur. Është një ndërtim e sipër. Edhe kemi kontraktuar një kompani e cila merret me trajtimin e qendrës. Ky problem do të ekzistojë prapë, sepse pa marrë parasysh sa efektiv edhe efikasive na, prapë ajo paraqitet, por besoj që e kemi zvogëluar këtë problem.

Për Zjarrfiksa gjëra e kemi problemin e mungesës së stafit, stacioni i zjarrfikseve në prezent ka mungesë staf i gjërave edhe nuk është kompetencë ligjore e komunës me e pranuar atë staf kur është kompetencë ligjore e agjencionit menaxhimit të emergjencave. Prandaj kjo është çështje për të cilën ne si komunë nuk kemi kompetenca ligjore. Për rrugën gjëra e bazë tek

është, po dhe kjo është kërkesë legjitime, por nuk e di a është rrugë veriore apo është rrugë që ndikon në territorin të komunës, që ashtu është rruga e komunës, do ta shqyrtojë mundësinë.

Autoambulanca për fshatin Gjonaj, dje kam folur me drejtorin e shëndetësisë dhe jemi marrë vesh, edhe me Azizin, edhe shumë shpejt qendra e mjekësisë familjare, Gjonaj e ka me pasur autoambulancën. Me stadiumin edhe me zhveshoret është u marrë Ademi, besoj që kjo do të rregullohet, kemi bërë kërkesën apo s'janë marrë parasysh apo janë injoruar. Po duhet me u përkujtuar që vitin e kaluar 96% të buxhetit është shpenzuar. Domethënë nuk është 100 vjet por vjen edhe ne s'i kemi shpenzuar. Kërkesat asnjëherë nuk injorohen, por nuk ka pasur mjete më tepër. Edhe ato kërkesat që i keni bërë ju nuk kanë mundur me marrë rend deri tash. Mirëpo, nga viti i ashtu, jam i sigurt që disa nga kërkesat që ju i paraqitët do të merren parasysh.

Edhe vazhdoi pastaj çdo vit nga pak. E përse i përket sigurisë së qytetarëve që s'është bë gjë. Më së pari duhet me pas kjo që çështja e sigurisë i takon policisë. Mirëpo komuna e ka bërë atë që ka bërë. Komuna ka investuar në vendosjen e kamerave të sigurisë, kurse ato kamera ku do të vendosen nuk e vlerëson komuna, e vlerëson policia. Domethënë bashkëpunim me policinë, caktohen vendet se ku vendosen kamerat e sigurisë.


Edhe policia e di ku është zonë më e rrezikshme, normal që ja fillon prej qendrave, prej parqeve. Po ai proces vazhdon më sipër dhe në momentin kur policia neve na thotë që një kamerë duhet në një lokacion apo në një fshat, atëherë ne do të vendosim atë, po është një proces e këtui është me rëndësi me theksuar se ka krejt indikatorët, krejt treguesit janë pozitiv. Domethënë është një proces me ngritje e sipër dhe jam shumë i sigurt që çdo pyetje e ardhshme do të ketë përmirësime. Përmirësimet për me qenë të qëndrueshme nuk duhet të jenë shumë të mëdhaja, se ne nuk mundem me orjentu veç me një fshat apo veç me një lokacion. Edhe aty doli zgjedhë krejt problemet, kurse në pjesën tjetër pastaj me pas mungesa serioze.

Po duhet një qasje e balancuar, shumë dimensionale prej çdo kanë vështrimi edhe në atë mënyrë gradualisht me rritë edhe atë efektivitetin e planifikimit buxhetor, për shkak se planifikimi i mirë edhe i suksesshëm pastaj në implementim nuk ka pengesa edhe nuk ka probleme.

Shaban Papiq, unë ju faleminderit shumë. Kështu, unë falënderohem për këtë mbledhje që jemi me ju. Për me bërë ato të mira që i keni bërë Prizrenit, me të vërtetë Shadrvani kuvendit komunal ato të gjitha po shiqoni kështu propozim direkte stadiumi i qytetit reflektorët për Parim Thaçi, Boka Boka të pastrohet dhe ja dy tre Korisha të ketë një fushë të vogël me barë artificiale, pastaj një pishinë, e meriton Prizreni një të vogël gjysëm olimpikë. E meriton një të madhe po ashtu. E pastaj subvencionet për këta OJQ-të duhet më tepër sepse OJQ-të janë ata që e përfaqësojnë jo Prizrenin, po Prizrenin në gjithë botë e bëjnë shtet, jo qytet. Edhe në çdo lagje ku janë, të bëhen ka një fushë të vogël të basketbollit. Pa marrë parasysh, sepse kemi treguar një sukses jashtëzakonisht të mirë që vjen në basketboll.

Konsultimi ka përfunduar në orën 11:11

Procesmbajtës/se:


Haziz Krasniqi
Besarta Caka